

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1082 / Prot.
3

Tiranë, më 22.04.2022

VENDIM


Nr. 34 , datë 13.04.2022

**“PËR PËRMBYLLJEN E PROCEDURAVE PËR PLOTËSIMIN E VENDIT VAKANT
PËRGJEGJËS NË NJËSINË E AUDITIT, NË UNIVERSITETIN E MJEKËSISË,
TIRANË”**

Në bazë të neneve 3, 47, 49 (shkronja f) të ligjit Nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; të Kodit të Punës së RSh; të Kodit të Procedurave Administrative; të ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”; të pikës 17 të Udhëzimit të Ministrit të Arsimit dhe Sportit nr.27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme...” të neneve 48, 49, 53 (pika 2) e vijuese të Statutit të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; të Rregullores së Universitetit të Mjekësisë, Tiranë; të vendimit nr.63 datë 08.10.2021 “Për miratimin e kritereve të punësimit të personelit administrativ të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë”; të vendimit nr.19 datë 09.03.2022 “Për fillimin e procedurave për plotësimin e vendit vakant ‘Përgjegjës’ në Njësinë e Auditit të Brendshëm, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë”, Bordi i Administrimit në mbledhjen e datës 13.04.2022,

VENDOSI:

1. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, që në emër të punëdhënësit, Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, për nënshkrimin e kontratës individuale të punës me punëmarrësin, ‘Përgjegjës’ në Njësinë e Auditit të Brendshëm, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;
2. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë dhe Drejtoria e Shërbimeve Juridike dhe Burimeve Njerëzore, për zbatimin e procedurave të rekrutimit, me qëllim plotësimin e vendit vakant ‘Përgjegjës’ në Njësinë e Auditit të Brendshëm, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë;



3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe të publikohet në faqjen zyrtare të internetit të UMT-së.

**KRYETARI
ZAMIRA GJINI**



**ANËTARË
VERA OSTRENI**




ALTINA XHAFERI



MONIKA FIDA



ALBANA GJINOPULLI



ANIS THODHORJANI



ENDRIT YZEIRAJ

